

Letërsi e huaj bashkëkohore  
Siegfried Lenz  
Një minutë heshtje  
DITURIA



Siegfried Lenz

# Një minutë heshtje

Përktheu: Elda Ymeri

Shtëpia Botuese DITURIA

Titulli në original:  
Siegfried Lenz  
*Schweigeminute*

Redaktore: Evisa Ibro  
Paraqitja grafike: Ulinda Selenica

© Copyright 2008 by Hoffmann und Campe Verlag,  
Hamburg

© Copyright për botimin shqip, Dituria 2010



Ky libër botohet me mbështetjen e TRADUKI,  
një rrjet online që i kushtohet letërsisë dhe është krijuar  
bashkërisht me nismën e Ministrisë Austriake për Punët  
Europiane dhe Ndërkombëtare, Ministrisë së Jashtme  
Gjermane, Këshillit të Arteve Zvicerane Pro Helvetia,  
KulturKontakt Austri, Institutit Gëte dhe  
Fondacionit Fisher.

Ulës



*Wir setzen uns mit Tränen nieder*, shkrihemi në lot: me këtë këngë kori i liceut e hapi ceremoninë përkujtimore, pastaj profesor Bloku, drejtori i shkollës, u drejtua nga podiumi i stolitur me lule. Me hapin e lehtë, me sytë që nuk e denjonin me asnjë vështrim sallën e mbushur plot, ndaloi përpara fotografisë së Stelës mbi këmbalecin përpara podiumit, ose të paktën kështu u duk dhe bëri një përkulje të thellë.

Sa kohë ndenji në atë pozicion përpara fotografisë tënde, Stela! Ajo fotografi e vijosur me të zezë, me një shirit të zi mëndafshi, një shirit për kujtimin tënd. Dhe ndërsa ai qëndronte atje, i përkulur, unë pashë fytyrën tënde, buzëqeshjen tënde të butë, kaq të njohur për ne nxënësit më të mëdhenj të kursit tënd të anglishtes. Flokët e tu të shkurtër dhe të zinj, që i kisha përkëdhelur, sytë e tu të çelët që i kisha puthur në plazhin e ishullit të Zogjve, më risollën në mendje atë herë që më sfidove për të gjetur moshën tënde. Profesori Blok foli nga podiumi pa e hequr vështrimin nga fotografia, të quajti, e dashura, shumë e nderuara Stela Petersen, kujtoi që bëje pjesë prej pesë vitesh në trupin mësimor të Liceut *Lessing* dhe se vlerësoheshe nga të gjithë kolegët dhe nxënësit të donin. Nuk harroi të përmendte veprimtarinë

tënde në komisionin për tekstet dhe në fund natyrën tënde gjithmonë gazmore: “Kushdo që shkante me të në ekskursionet mësimore, ruante përgjithmonë me vete kujtimin e ideve të saj, të humorit të mirë, që dinte t’ua përçonte të gjithë nxënësve së bashku me ndjenjën e përkatësisë në institutin tonë, krenarinë e të qenit lesingianë, këtë ndjenjë ia detyrojmë asaj.”

- Shshsh!... Qetësi! - Nga ana e murit me dritare, një mësues përpiquej t’i rikthente në rresht më të vegjlit, gjimnazistët që nuk pushonin së foluri për gjëra sigurisht tërheqëse për ta, përpëliteshin, shtyheshin dhe shkëmbejnë mendime. Sa mirë dukeshë në atë fotografi! Gati gjithçka e saj ishte e njohur për mua: pulovri i gjelbër, shalli prej mëndafshi me spiranca. E kishe veshur edhe atëherë, në plazhin e ishullit të Zogjve, kur u strehuam atje për t’u mbrojtur nga stuhia.

Pas drejtorit të shkollës, duhet të fliste edhe një nxënës. Ma kishin kërkuar mua si përfaqësues i klasës, por kisha refuzuar, e dija se nuk do të isha në gjendje ta bëja pas asaj që kishte ndodhur. Kështu i takoi Georg Bisanzit, që veç kësaj kishte këmbëngulur që të thoshte dy fjalë për kujtim të mësuese Petersenit. Ai, që kishte qenë nxënësi i saj i preferuar dhe që merrte notat më të mira. Kushedi çfarë do të kishe thënë Stela, duke e dëgjuar të fliste për udhëtimin tonë të diturisë, për atë shëtitje në ishujt e Frisisheve të Veriut, ku roja i vjetër i farit na tregoi gjithçka për punën e tij dhe ku peshkuam shojzat e detit me këmbët poshtë rërës gjatë zbatcës dhe ishe pikërisht ti që gjete më shumë nga të gjithë. Georgi nuk la pa kujtuar as mbrëmjen në hotel. Dhe foli vërtet në emër të të gjithëve kur lavdëroi shojzat e pjekura. Dhe me siguri në emrin tim, kur kujtoi me



entuziazëm mbrëmjen me këngë detarësh.

Të gjithë kënduam atë mbrëmje, dinim *My Bonnie, Wir lagen vor Madagascar* dhe gjithë të tjerat. Unë piva dy gota me birra, por edhe ti Stela, natyrisht nuk refuzove të pije. Ndonjëherë dukeshë vërtet një nga ne, një shoqja jonë, së cilës i pëlqente gjithçka që na pëlqente ne, edhe ti ia plase të qeshurit kur njëri nga ne u vuri në kokë kapele të vogla prej letre zogjve detarë të balsamosur, që qenë shpërndarë kudo.

- Të gjithë ne, kolegë të dashur, u gëzuam kur dy nxënësit tanë fituan një bursë studimi për në Oxford,- tha drejtori i shkollës dhe për ta theksuar vlerën e atyre fjalëve, bëri një shenjë me kokë në drejtim të fotografisë tënde, duke përsëritur me zë të ulët: - Një bursë studimi për në Oksford,- a thua se ai pohim mund të kuptohej edhe kushedi në çfarë mënyre tjetër.

Papritur u dëgjua një e qarë me dënesë. Burri që përpiquej t'i fshihte lotët pas dorës, ishte profesor Kugleri, mësuesi ynë i artit. I kishim parë shpesh të ktheheshin në shtëpi së bashku. Ndonjëherë ti mbështeteshe tek ai dhe meqë Kugleri ishte shumë më i gjatë, dukej sikur të hiqte zvarrë peshë. Disa nxënës i ranë njëri-tjetrit me bërryl, duke treguar profesorin që ngashërehej dhe me vështirësi arritën t'ua mbyllnin gojën dy gjimnazistëve që vazhdonin të qeshnin nën hundë.

Profesor Kugleri nuk ishte midis kureshtarëve që përpiquehin të na shikonin ditën kur punuam te diga dallgëpritëse. Po endej andej-këndej me barkën e tij me vela midis ishujve danezë. Përndryshe, i gjatë siç ishte dhe me atë dobësinë e tij turbulluese, do ta kisha vënë re menjëherë. Pjesa më e madhe e kureshtarëve

përbëhej nga pushues.

Vinin gjatë plazhit nga hotel *Seeblick*, disa me rroba banje dhe e përshkonin të gjithë rrugën deri në majë të molit, duke ndaluar në afërsi të farit ose mbi një nga gurët e mëdhenj të dalë. Lundra jonë e zezë lundruese, krejt e rrjepur, e pajisur për transportin e blloqeve dallgëpritëse, ishte ancoruar në afërsi të hyrjes së portit të Hirtshafenit, e mbajtur nga dy çengelë, deri në buzë plot me shkëmbinj të bërë pis me baltë dhe alga, që kishim ngarkuar me qëllim që të zgjeronim dhe të ngrinim digën dallgëthyesë dhe të rregullonim përsëri molin e dëmtuar nga stuhitë dimërore. Një erë e lehtë verilindorem, premtonte mot të qëndrueshëm.

Nga një shenjë e babait tim, Frederiku punëtori i tij, e bëri drekun e vinçit të rrotullohet dhe e lëshoi kovën mbi një shkëmb, duke e kapur fort me dhëmbët metalikë. Arganoja u vu në lëvizje, shkëmbi u ngrit me hov në urën lundruese, duke u lëkundur lehtë dhe u mbart jashtë bordit. Spektatorët vështruan nga ne, njëri mori aparatin fotografik. Babai im bëri një shenjë tjetër dhe dhëmbët e kovës u hapën, e lanë shkëmbin të binte dhe në pikën në të cilën shkëmbi ra, uji u ngrit, zjeu përsëri dhe u ngritën dallgë të mëdha, për t'u derdhur njëra mbi tjetrën dhe për t'u shpërndarë pastaj dalëngadalë.

Në atë çast mora maskën dhe u lëshova në ujë, duke u mbështetur në buzë të urës lundruese për të kontrolluar vendosjen e shkëmbinjve, por isha i detyruar të prisja që reja e baltës dhe e rërës së sapongritur të depozitohet ose të shpërndahej nga rryma e lehtë, përpara se të vëreja se edhe ai shkëmb kishte zënë vend. Qe vënë tërthorazi sipër shkëmbinjve të tjerë, duke krijuar me ta

ca plasa dhe të çara që do të lejonte kalimin e dobishëm të rrymave nëndetare. Im atë më vështroi me pamje pyetëse, unë e qetësova: gjithçka ishte në rregull, diga dallgëthyesë po ngrihej siç duhet. U ngjita përsëri në bord; Frederiku më zgjati paketën e tij të cigareve dhe më bëri ta ndez.

Përpara se ta lëshonte përsëri kovën mbi ngarkesën e shkëmbinjve, ishte ai që ma tërhoqi vëmendjen mbi spektatorët: “Ej, Kristian, ajo vajza me rroba banje të gjelbra dhe me çantë plazhi besoj se po të bën ca shenja.” E njoha menjëherë nga krehja, nga fytyra buzagaze, Stela Peterseni, mësuesja ime e anglishtes në liceun *Lessing*. “E njeh?” pyeti Frederiku. “Është mësuesja ime e anglishtes,” thashë dhe Frederiku vazhdoi mosbesues: “Ajo? Duket më shumë si një nxënëse.” “Mos u gënje,- ia ktheva unë,- e ka, e ka moshën e vet.”

Të njoha menjëherë, Stela dhe mendova për bisedën tonë të fundit përpara pushimit, për fjalët e tua inkurajuese:- Po të doni një notë të mirë, Kristian, duhet të bëni më shumë: lexoni *The Adventures of Huck Finn* dhe *Animal Farm*. Do t’i thellojmë pas pushimeve. Frederiku më pyeti nëse shkoja mirë me atë mësuese.- Jo dhe aq,- u përgjigja.

Ajo, e vëzhgonte me shumë interes Frederikun, që e lëshoi përsëri kovën mbi një shkëmb të madh, të zi. E ngriti paksa, e mbajti për ndonjë sekondë mbi urën pothuaj të zbrazur, por pastaj shkëmbi rrëshqiti midis dhëmbëve prej metali, pa mundur që ai ta ndalonte dot dhe ra përsëri me një pëlltum në urën lundruese të veshur me llamarinë çeliku, kaq fort sa e bëri të gjithë barkën të dridhet. Ajo na thirri, na bëri shenja, na bëri të kuptojmë me gjeste se donte të hipte me ne në urën

lundruese. Mora pasarelën, e shtyva jashtë bordit dhe e mbështeta mbi një shkëmb të sheshtë në bazën e molit. Pa ngurruar, me vendosmëri, ajo kërceu sipër, duke u lëkundur dy apo tri herë përpara se të gjente drejtpeshimin; unë i shtriva dorën dhe e ndihmova të ngjitej. Im atë nuk u duk veçanërisht i kënaqur të kishte një të ftuar në bord, u kufizua duke më parë, duke pritur që të bëja prezantimet. “Mësuesja ime, mësuesja e anglishtes, zonja Petersen,”- thashë. Ai u përgjigj: “Nuk ka ndonjë gjë për të parë këtu,” dhe i zgjati dorën me një buzëqeshje, duke shtuar: “Shpresoj që Kristiani të mos ju krijojë shumë probleme në shkollë.” Përpara se të përgjigjej ajo më vëzhgoi me pamje hetuese, a thua se nuk qe ende krejt e sigurt për gjykimin e saj; por pastaj me ton pothuajse asnjanes u përgjigj: “Kristiani sillet mirë.” Im atë u kufizua me një shenjë aprovimi, ishte pikërisht përgjigja që priste; pastaj kureshtar siç ishte, filloi të bënte shumë pyetje të tjera. E pyeti nëse ishte atje për festën e Hirtshafenit që tërhiqte një mori njerëzish, të cilës Stela, duke tundur kokën iu përgjigj se disa miq të saj po endeshin andej-këndej me një jaht dhe duhej të kalonin për ta marrë në Hirtshafen në një nga këto ditë.

- Është një bregdet shumë i bukur,- tha babai im,- shumë amatorë velierë e vlerësojnë.

Barka e parë që e kapërceu atë ditë digën dallgëthyese, që sapo e kishim ngritur përsëri, ishte një anije peshkimi që po kthehej në port. Rrëshqiti e sigurt përmes hyrjes; peshkatari që e ngiste e vuri motorin në minimum dhe u afrua te ne. Kur im atë e pyeti si kishte shkuar peshkimi, ai me një shenjë të kokës tregoi arkat me merluc dhe me skumbri gjysmë

të zbrazëta. Kish qenë një ditë e zezë, e mbarë sa për të paguar naftën, pak shtojëza, pak ngjala; pastaj, pranë ishullit të Zogjive, i ishte ngatërruar në rrjetë siluri i një manovre ushtarake, që e kishte dorëzuar te roja bregdetare. Vështroi shkëmbinjtë që kishim hedhur në ujë, pastaj sasinë e peshkuar dhe me zë miqësor tha: “Ty, përkundrazi, të vete gjithmonë mirë, Vilhelm, atë që të duhet shkon ta marrësh, gurët rrinë në vendin e vet, gurëve mund t’u besosh.” Im atë e bëri veten që t’i jepte ca peshq, duke thënë se do t’i paguante më vonë; pastaj i kthyer nga Stela shpjegoi: “Në ujë nuk bëhet kurrë biznes.” Kur peshkatarin me anijen e tij të peshkimit iku, im atë i tha Frederikut të merrte gotat dhe të na jepte një çaj. Frederiku i dha një gotë edhe Stelës, por ajo nuk e pranoi rumin që donte të shtonte te çaji. Por më pas Frederiku i shërbeu vetes aq bujarisht, sa që babai im u detyrua ta qortonte.

Shkëmbinjtë e fundit të ngarkesës sonë, Frederiku i ngarkoi shumë ngadalë. E rrotullonte vinçin, duke i vendosur shumë afër sipërfaqes së ujit. Ku ngrihej ose duhet të ngrihej diga dallgëthyesë, e ulte kovën pa e lënë shkëmbin të binte, por duke e ulur poshtë, duke pohuar pastaj me kokë i kënaqur, kur uji e mbulonte, duke e përpirë.

Të ngjallnin kureshtje ata shkëmbinj gjigantë, Stela pyete sa kohë kishin qëndruar në fund të detit, si i zbulonim, ku i merrnim; te disa mendoje se shikoje forma krijesash fosile të ngurosurë në përjetësi.

- A është e vështirë t’i gesh?

- Një peshkatar shkëmbinjsh di ku t’i marrë,- u përgjigja.- Babai im njuh gurore të tëra dhe shkëmbinj të vjetër nënujorë artificialë, të krijuar me qindra vjet

më parë, atje shkon të kërkojë. Hartën me thellësitë e ujit më të pasura me shkëmbinj e ka të vizatuar në kokë.

- Do të më pëlqente vërtet t'i shikoja një ditë këto gurore,- tha Stela.

Dikush e thërriste, një nga djemtë e vendit kishte çarë rrugën midis kureshtarëve dhe po thërriste emrin e saj dhe meqenëse ajo dukej se nuk dëgjonte, u hodh nga moli dhe me pak not pash arriti urën tonë lundruese. I shkathët, u kacavirr te shkalla prej litari, duke u ngjitur në bord. Pa na vështruar fare iu kthye drejtpërsëdrejti Stelës, duke i njoftuar atë që duhet t'i thoshte: në telefon, e kishin kërkuar në telefon në hotel, duhet të gjendej atje kur t'i telefononin përsëri. Dhe si për të nënvizuar rëndësinë e detyrës së tij, shtoi: "Duhet ta marr prapa me vete."

Ishte Sveni, një djalë gjithmonë gazmor, me fytyrën plot me preka, notari më i mirë që kisha njohur ndonjëherë. Nuk më habiti kur bëri një shenjë nga hoteli, duke treguar skelën e gjatë prej druri dhe i propozoi Stelës ta arrinin së bashku me not. Madje e sfidoi të bënin garë. Dhe ajo qe kaq e kënaqur, saqë e tërhoqi pas vetes, por nuk e pranoi ofertën. "Një herë tjetër,- tha,- e bëjmë njëherë tjetër." Pa e pyetur për asgjë, mora barkën e gomës që ishte mbërthyer tek ura lundruese me një cimë të gjatë dhe ajo u ngjit në bord që ta shoqëroja deri te skela prej druri.

Hipi edhe Sveni dhe shkoi të ulej pranë saj dhe ia pushtoi me natyrshmëri supet me njërin krah. E vura në lëvizje dhe barka me motor jashtë bordit, filloi të shtyjë barkën e gomës me një shpejtësi të rregullt. Gjatë udhëtimit, Stela futi njërën dorë në ujë, Sveni mori pak ujë deti tek e vetja dhe e pikoi në kurrizin e saj: Stela e

lejoj që ta bënte.

Ishte e pamundur të ankorroje te skela, sepse kudo qenë venduar Optimistët e vegjël. Gara e tyre me barkë, ishte një nga ndodhitë kulminante të festës së madhe të detit. Me të mbërritur në plazh, Sveni kërceu poshtë nga barka e gomës dhe na parapriu për në hotel me vrullin e lajmëtarit që e ka çuar me sukses deri në fund misionin e tij.

Kamerierët po çonin jashtë karrige dhe tavolina, një mikrobus kampimi i caktuar për restaurim, manovronte për t'u vendosur poshtë një bredhi me kurora të shpurpurisura nga era. Në sheshin ranor, ishin vendosur për së gjëri disa fije me llamba të ngjyrosura, të mbajtura nga shtyllat. Mbi një kodër të vogël ishte përgatitur vendi për orkestrën. Në bovat e sinjalizimit të nxjerra në stere për t'u lyer përsëri me vernik, qenë ulur për të biseduar disa pleq që inspektonin përgatitjet e festës dhe bënin krahasime me festat e mëparshme. Askush nuk iu përgjigj përsëritjes sime.

Meqenëse Stela nuk kthehej, u ngjita deri në hotel.

Te hyrja, një burrë me uniformë nuk diti apo nuk desh të më thoshte gjë tjetër veçse që zonja Petersen kishte bërë një telefonatë dhe pastaj kishte shkuar në dhomën e saj. Nuk dëshironte ta shqetësonin.

U ktheva vetëm tek ura lundruese ku më prisnin im atë dhe Frederiku për të më dërguar nën ujë, që të kontrolloja vendosjen e shkëmbinjve. Nuk kishte shumë për të korigjuar. Vetëm herë pas here e drejtova kovën drejt ndonjë shkëmbi, duke sinjalizuar Frederikun në çfarë drejtimi ta lëvizte dhe ku ta zbriste. Njëherë pashë hijen e një shkëmbi sipër meje, midis dhëmbëve të kovës dhe pa i bërë asnjë sinjal Frederikut mendova menjëherë të shpëtoja. Ai shkëmb nuk shkoi në vendin e